



Help – Hilfe zur Selbsthilfe E.V.
Mission to the Republic of Kosovo
Str: Ekrem Rexha, H2, B1, Nr: 4
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo
Tel.: +381 38 704 302
www.help-ev.de/en
<http://help-kosovo.org>
www.facebook.com/helpkosovo

PROJEKTI:
“MBËSHTETJE STABILITETIT
SOCIO-EKONOMIK PËRMES
FUQIZIMIT TË SEKTORIT TË MIKRO
BIZNESIT NË KOSOVË”

Raport Përmbledhës
shkurt – tetor 2016

Rreth projektit:

Projekti financohet nga Qeveria Gjermane, Qeveria e Kosovës, Komunitat partnerë ndërsa zbatohet nga organizata Help-Hilfe zur Selbsthilfe e.V. Misioni në Republikën e Kosovës.

Projekti "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro-bizneseve në Kosovë" ka filluar me zbatimin e projektit në Kosovë që nga maji 2015 dhe do të përfundojë në dhjetor 2017.

Komunitat e synuar janë: Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Graçanicë, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Vushtrri, Gjakovë, Gjiçan, Pejë, Podujevë dhe Novobërdë.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në zhvillim të qëndrueshëm dhe stabilitet në Kosovë me fokus kryesor fuqizimin ekonomik. Përderisa, qëllimi i veçantë është krijimi i vendeve të reja të punës përmes mbështetjes direkte me grante për biznese mikro.

Nëpërmjet këtij projekti, shpërndahen grante, duke ofruar pajisje në mënyrë që përfituesit të mund të fillojnë apo rrisin biznesin e tyre. Vlera totale mesatare e një granti, për një përfitues, është 2,000.00 Euro, shumë kjo e cila përfshinë edhe investimin nga përfituesit prej 15%. Krahas pajisjeve, përfituesve do t'u ofrohen edhe trajnime profesionale dhe mbështetje teknike pasi të kenë pranuar pajisjet.

Komponentë I e projektit - Grante për mikrobiznese

Në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe të interesuarit tjerë relevant që merren me zhvillimin e ekonomisë lokale, organizata Help ka vlerësuar situatën në mënyrë që të përkrahë bizneset që më së miri i kontribuojnë zhvillimit lokal në secilën komunë të synuar. Për këtë arsye, fushat me prioritet do të adresohen në secilën prej komunave të synuara gjatë zbatimit të projektit.

Komponentë II e projektit - Trajnime profesionale dhe mbështetje teknike

Duke marrë parasysh të gjitha karakteristikat specifike dhe duke u bazuar në nevojat e aplikuesve do të zhvillohet dhe do të ju ofrohet një kombinim i trajnimeve të definuara mirë për secilin aplikant dhe do të zbatohet në bashkëpunim me ofruesit e trajnimeve. Trajnimet e biznesit do të ofrojnë aftësi bazike në ndërmarrësi, siç është përgatitja e planit të biznesit, gjetja e burimeve alternative të fondeve, marketingut, planifikimi dhe kontrolli financiar, menaxhimi, baza ligjore për bizneset e vogla. Përderisa mbështetja teknike është e dizajnuar dhe organizuar për të rritur kapacitetet, të rritur efikasitetin e bizneseve të vogla duke krijuar kështu mundësi për performancën konkurruese dhe si rezultat përfundimtar përfitimit afatgjatë.

Bashkëpunimi me Komunitat e Prishtinës

Duke u bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Komunitatës së Prishtinës dhe Help-Hilfe zur Selbsthilfe e.V, e nënshkruar me datë: 18.06.2015 palët janë pajtuar që të nënshkruhet aneksi marrëveshja e bashkëpunimit me qëllim të vazhdimit të projektit "Mbështetje për stabilitetin socio-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikro biznesit në Kosovë", deri në fund të vitit 2017.

Në kuadër të projektit të ri të paktën edhe 73 biznese do të mbështeten, përveç 100 biznese të planifikuara më parë në synimet e tyre për fillimin apo zhvillimin e bizneseve, mbështetja do të përfshijë:

- Donacionin e pajisjeve në vlerë mesatare prej 2, 000 Euro
- Organizimin e trajnimeve profesionale për biznese, sipas nevojave të klientëve
- Monitorimin e ndërmarrjeve të mbështetura.

Për zbatimin e projektit që është vazhduar me aneks marrëveshje vlejshme edhe rregullat e marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Komunes së Prishtinës dhe Help e nënshkruar me datë: 18.06.2015.

Vlera e projektit është 1,415,700.00 Euro, duke përfshirë këtu vitin 2016 dhe 2017.

Projekti i ri "Mbështetje për stabilitetin socio-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikro biznesit në Kosovë - Parandalimi i Migracionit dhe Stabilizimi" përfshin edhe fazën II siç fillimisht ishte e planifikuar por tani me aktivitete shtesë të parapara për 2017.

Komuna do të transferojë në llogarinë e Help, kontributin shtesë në shumën prej 29.200,00 Euro në 2017, përveç shumes 40,000.00 Euro të kontraktuara më parë si pjesëmarrje në drejtim të zbatimit të projektit në kuadër të Komunes së Prishtinës. I tërë kontributi i Komunes për projektin "Mbështetje për stabilitetin socio-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikro biznesit në Kosovë" dhe vazhdimin e projektit të ri "Mbështetje për stabilitetin socio-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikro biznesit në Kosovë - Parandalimi i Migracionit dhe Stabilizimi" është 69.200,00 euro.

Kësti i trete i kontributit për vazhdimin e projektit do të transferohen në shumën prej 29.200,00 euro jo më vonë se 31 Mars 2017.

Projekti në Komunën e Prishtinës ka vazhduar me zbatimin menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes. Përgjatë zbatimit të projektit gjatë periudhës 2015, 88 biznese kanë përfituar nga skema e granteve. Në vitin 2016-2017 do të përfitojnë të paktën 100 biznese.

Mbështetja përfshijnë:

- 1) Donacion i pajisjeve në vlerë mesatare prej 2, 000 Euro
- 2) Organizimi i trajnimeve profesionale sipas nevojave të klientit
- 3) Monitorimi i bizneseve të mbështetura.

Aktivitetet

Gjate muajit shkurt 2016 thirrja për aplikim, udhëzuesi për aplikim, forma e aplikacionit janë zhvilluar, ndërsa pllakatet dhe broshurat janë zhvilluar dhe shpërndarë në pjesën urbane dhe rurale të Komunes së Prishtinës me qëllim që qytetarët të informohen rreth mundësisë së aplikimit për grant. Po ashtu në shkurt të 2016 është mbajtur seanca informuese me qytetarët e interesuar për këtë mundësi.

Klientët potencial kanë pasur qasje në informata në faqen e internetit të organizatës Gjermane Help dhe në mediat sociale siç është Facebook, Twitter ku kërkesat e tyre janë trajtuar menjëherë dhe në mënyrë efektive.

Afati i fundit për aplikim në Komunën e Prishtinës është vendosur 31 mars 2016. Përgjatë afatit të aplikimit duke filluar nga 01 deri me 31 mars 2016 në fahun postar të Help-Hilfe zur Selbsthilfe e.V. Misioni në Republikën e Kosovës gjithsejtë nga Komuna e Prishtinës kanë ardhur 565 aplikacione. Gjate muajit maj 2016 është bërë regjistrimi i aplikacioneve dhe përzgjedhja për fazën e parë.

Ne qershor 2016 ka filluar faza e dytë e dyte e përzgjedhjes përfshirë këtu vizitat në terren (ne shtëpitë e përfituesve potencial ose vendet e tyre te punës). Gjithsejtë janë zbatuar 182 vizita ne terren, ne zona urbane dhe rurale te Komunës se Prishtinës.

Llojet e veprimtarive te vizituara kane qene te ndryshme, qe nga idetë inovative, ofruesit e shërbimeve, zeytare, zhvilluesit e aplikacioneve për teknologji informative deri te klientët potencial nga fusha e bujqësisë.

Ne muajin korrik 2016 pas përfundimit te fazës se dyte te përzgjedhjes, përfaqësuesit e organizatës Help suksesshëm kane përmbyllur procesin e përzgjedhjes dhe është gjeneruar lista finale e klientëve te përzgjedhur ne Komunën e Prishtinës.

Ne total 99 klientë do te përfitojnë gjate 2016 dhe 2017. Nëse gjate procesit te prokurimit kursehet buxhet atëherë shtohet numri i klientëve.

Te planifikuar sipas projektit ne vitin 2016 do te përfitonin 20 klientë dhe ne vitin 2017 do te përfitonin 73 klientë. Por, meqenëse Help ka pranuar numër ta madh te aplikacioneve (563), si ne sasi po ashtu edhe ne cilësi Help ka vendosur te beje përzgjedhjen edhe për vitin 2017. Kështu qe ne vitin 2017 nuk do te ketë thirrje për aplikim por do e përmbyllim përzgjedhjen këtë vit.

Ne muajin shtator 2016 Help ka filluar me procesin e tenderimit dhe se shpejti fillon me shpërndarjen e pajisjeve tek klientët e përzgjedhur. Po ashtu me ofrimin e trajnimeve sipas nevojave dhe kërkesave te klientëve.

Shqipe Breznica
Koordinatorë e Programit



Help – Hilfe zur Selbsthilfe e.V.
Str: Ekrem Rexha, H2, B1, Nr: 4
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo
Tel.: +381 38 704 302

breznica@help-ev.de | www.help-ev.de/en
<http://help-kosovo.org> | www.facebook.com/helpkosovo